URDHËR
Nr. 6, datë 5.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.
2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
2.	Veneto	Verona	Oppeano*
3.	Veneto	Verona	Isola Della Scala*
4.	Piemonte	Alessandria	Occimiano*
5.	Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
6.	Emilia-Romagna	Forli' - Cesena	Forlì*
7.	Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
8.	Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
9.	Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolasco*
10.	Emilia-Romagna	Bologna	San Giovanni In Persiceto*
11.	Emilia-Romagna	Modena	Soliera*
12.	Emilia-Romagna	Ferrara	Voghiera*
13.	Emilia-Romagna	Modena	Modena*
14.	Lombardia	Brescia	Seniga*
15.	Piemonte	Novara	Novara*
16.	Lombardia	Mantua	Guidizzolo*
17.	Lombardia	Varese	Olgiate Olona*
18.	Lombardia	Mantua	Ceresara*
19.	Veneto	Venezia	Mira*
20.	Lombardia	Mantua	Goito*
21.	Lombardia	Mantua	Marmirolo*
22.	Lombardia	Mantua	Roverbella*
23.	Verona	Verona	Nogarole Rocca*
24.	Emilia-Romagna	Ferrara	Argenta*
25.	Piemonte	Torino	Front*

26.	Toscana	Pistoia	Agliana*
27.	**Veneto**	**Treviso**	**Fonte***
28.	**Emilia-Romagna**	**Ravenna**	**Lugo***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5 Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6.Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1409, datë 24.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla